



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 52/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Kryesuesit të vendvotimit Ilir Ibërhysaj për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, A-52 e datës 10.01.2011.

ARSYETIM

Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN me seli në Prishtinë ka parashtruar ankesë për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, duke pretenduar se më datë 09.01.2011 në QV 0101c VV 01R, në shkollën e mesme “Vllëzërit Frashëri” në Komunën e Deçanit, në orën 16:00, kryesuesi i VV Ilir Ibërhysaj, së bashku me komisionar të tjerë të këtij VV në kundërshtim me nenin 90 të LZP-së e lejojnë votuesen Gjyle Balaj të cilën e kishte shoqëruar nipi i saj, Visar Loshaj që të votoj me dokument identifikimi të papranueshëm-kartelë bankare.

Më 10 janar 2011, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga BIRN, duke pretenduar se ka pasur parregullsi në QV 0101c VV 01R gjatë procesit të votimit.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

- ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesa e BIRN-it, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë materiale si dëshmi bindëse lidhur me parregullsinë e pretenduar se votuesja Gjyle Balaj ka votuar me kartelë bankare, dokument i cili nuk bënë pjesë në radhën e dokumentacionit të vlefshëm për votim. Për këto arsye, dhe duke u bazuar ne dispozitat e lartpërmendura si dhe ne kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 52/2011 më datën 13.01.2011.

